



Pranuar / Dorezuar Primitjen/Prodato Received/Delivery	16.11.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7150/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.845/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari, dhe Ardita Haxhnikaj - Demi, anëtare, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.845/2022, të datës 03.10.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit/Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.11.2022, mori këtë.

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.845/2022 e datës 03.10.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.29/2022 i datës 29.08.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] punësuar në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë në Gjykatën Themelore në Ferizaj - Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 29.09.2022 ka parashtruar ankesë e cila është pranuar përmes postes me datë 03.10.2022 dhe është regjistruar me numër protokollit 5820/2022, nën shenjen A.nr.845/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.29/22 të datës

29.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, ligjit material dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa me datë 03.11.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën e dorëzuar përmes postes me datë 29.09.2022 e cila është pranuar me datë 03.10.2022 dhe është regjistruar me numër protokolli 5820/2022, nën shenjen A.nr.845/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr.29/22 të datës 29.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimit e datës 23.03.2022 të ankuesit; Vendimin e datës 27.12.2017 me numër KGJK 366/2017; Ankesën e datës 18.08.2022 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Shkresën e datës 15.02.2018 të DASHC/MAP; Përgjigjen në ankesë të datës 03.11.2022, me numër protokolli 6665/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pa bazuar sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit Nr.Ref: DS-164/2020 të datës 22.03.2020 (*data vështirë e lexueshme*) është i emëruar në pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë*, me koeficient të pagës nëntë (9), në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Ankuesi, me datë 18.08.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimin ankimor për harmonizimin e koeficientit të pagës, nga koeficienti aktual nëntë (9), në koeficient të pagës trembëdhjetë (13), si dhe kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga muaji prill 2020 deri në muajin gusht 2022, duke u bazuar në Vendimin Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, me datë 29.08.2022 me Vendimin KA.nr.29/2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar me arsyetimin se me Vendimin Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë harmonizuar pagat/koeficientet e punonjësve mbështetës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe gjykata, në nivel të njëjtë me punonjësit mbështetës të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, dhe prokurorive, ku sipas këtij vendimi parashihet se pozita aktuale e ankuesit "*Udhëheqës i Zyrës në Gjykatë*" me koeficient tetë (8) harmonizohet/ngritët në koeficient nëntë (9), sikurse në prokurori, e cila është lejuar edhe me shkresën e datës 13.02.2018 të Ministrisë së Administratës Publike, lidhur me procedimin

në sistemin e pagave - Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Tutje sipas konstatimit të KZKA-së ankuesi me Akt Emërimin Nr.Ref: DS-164/2020 të datës 22.03.2020 e ka koeficientin nëntë (9) sikurse parashihet me Vendimin Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Shkresën e datës 13.02.2018 të Ministrisë së Administratës Publike, lidhur me procedimin në sistemin e pagave - Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Kundër Vendimit KA.nr.29/2022 të datë 29.08.2022 të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, ligjit material dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse sipas të njëjtit, vendimi i kontestuar, gjegjësisht Vendimi KA.nr.29/2022 i datës 29.08.2022 nuk i përmban elementet e aktit administrativ të kërkuara sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, veçanërisht për shkak të mungesës së arsytimit të tij. Me tutje ankuesi pretendon se arsytimi i vendimit të kontestuar përmban të dhëna të paqarta, kontradiktore dhe të pasakta, pasi që në rastin konkret sipas Akt Emërimin Nr.Ref: DS-164/2020 të datës 22.03.2020 koeficienti i pagës është nëntë (9), ndërsa me Vendimin Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për pozitën përkatëse të punës parashihet koeficienti i pagës trembëdhjetë (13). Ankuesi po ashtu pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka marr parasysh Vendimin Nr.366/2017 të datës 27.12.2017, të cilin ka qenë i obliguar të zbatoj dhe rrjedhimisht gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale apo i ka anashkaluar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, neni 3 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.*

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur se Këshilli Gjyqësor i Kosovës me qëllim të harmonizimit të pagave të stafit administrativ në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor dhe stafit administrativ në gjykata, me pagat e punonjësve mbështetës të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial dhe punonjësve mbështetës të prokurorive, në mbledhjen e 196 të mbajtur me datë 27.12.2017, ka nxjerr Vendimin Nr.366/2017, përmes të cilit ka përcaktuar koeficientet e pagave për stafin administrativ të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor dhe stafin administrativ të gjykatave, ndërsa Ministria e Administratës Publike - Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, me shkresën e datës 13.02.2018 ka aprovuar koeficientet e pagave për punonjësit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas Vendimit Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 dhe të njëjtit i kishte proceduar në sistemin e pagave.

Kolegji i Këshillit, duke ju referuar Vendimit Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 si dhe Shkresës të datës 13.02.2018 të Ministrisë së Administratës Publike, konstatoi se koeficienti i pagës *Udhëheqës i Divizionit* në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës kishte qenë nëntë (9), ndërsa për pozitën e njëjtë të punës është përcaktuar të ngritët koeficienti në trembëdhjetë (13), deri sa për pozitën e punës *Udhëheqës i Zyrës* në Gjykatë koeficienti i pagës kishte qenë tetë (8), ndërsa për pozitën e njëjtë të punës është përcaktuar të ngritët koeficienti në nëntë

(9). Ky vendim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës kishte hyrë në fuqi me datë 27.12.2017, ndërsa kishte filluar se zbatuari nga data 01.01.2018.

Andaj, duke marr parasysh se ankuesi sipas Akt Emërimit Nr.Ref: DS-164/2020 të datës 22.03.2020 (*data vështirë e lexueshme*) është i emëruar në pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë*, me koeficient të pagës nëntë (9), në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Kolegji i Këshillit vlerëson se i njëjti realizon pagën sipas Vendimit Nr.366/2017 të datës 27.12.2017, sepse me vet aktin e emërimit është përcaktuara se institucioni ku ankuesi ushtron detyrën është Gjykata Themelore në Ferizaj, dhe se me Vendimin Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 janë të përcaktuara pagat për stafin mbështetës në gjykata, ku pozita e Administratorit të Gjykatës është pozita me e lartë udhëheqës, me koeficient të pagës dhjetë (10), ndërsa për pozitën e Udhëheqësit të Zyrës në Gjykatë, koeficienti i pagës është nëntë (9).

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimi KA.nr.29/2022 i datës 29.08.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk është i përfshirë në shkelje procedurale siç pretendon ankuesi, sepse vendimi si i tillë përmban elementet e aktit administrativ, gjegjësisht pjesën hyrës, pjesën urdhëruese, pjesën arsyetuese dhe pjesën përmbyllëse, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe po ashtu në me aktin e kontestuar është vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë është zbatuar ligji material ngase me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht dispozitat e nenit 9 paragrafi 1 përcaktohet se: *1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës*, kështu që organi i shkalles se parë kishte konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit Nr.Ref: DS-164/2020 të datës 22.03.2020 realizon koeficientin e pagës nëntë (9) ashtu siç është përcaktuara koeficienti i pagave edhe me Vendimin Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 për pozitat e stafit mbështetës të Gjykatave, të cilin konstatim e mbështet në tersi si të drejte dhe të ligjshëm edhe Kolegji i Këshillit, ngase ankuesi nuk ka mundur të vërtetoj me asnjë provë të vetme se pozita të cilën e ushtron ankuesi "*Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë*" hynë në kuadër të pozitave të stafit mbështetës të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, ndërsa me Aktin e Emërimit Nr.Ref: DS-164/2020 të datës 22.03.2020 është konstatuar se ankuesi realizon pagën sipas koeficientit nëntë (9) dhe se institucioni ku ankuesi ushtron detyrën është Gjykata Themelore në Ferizaj, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit koeficienti i pagës të cilin është duke realizuar ankuesi është në pajtim me Vendimin Nr.366/2017 të datës 27.12.2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilin ishin përcaktuar pagat për stafin administrativ në Gjykata, dhe se pretendimi ankimor për harmonizimin e koeficientit të pagës nga koeficienti nëntë (9), në koeficientin e pagës trembëdhjetë (13) është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.845/2022

Ruslir KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK);
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.